

I – INFORMACION I PERGJITHSHEM DHE POLITIKAT KONTABEL

*Emri Njesisë Ekonomike, Selia dhe Forma Ligjore

Shoqëria "DARDANIA HAS" SHPK është krijuar si shoqëri SHPK me një ortak të vetëm Muharrem SHETA 50 % dhe Ram SHETA 50 %, me Vendim Gjykatë Nr.9356 datë 01.03.1995 dhe QKR 15.03.2006 Krumë, dhe me Vendimin Nr.1 datë 01.02.2006 të ortakëve DARDANIA HAS SHPK është vendosur largimi i z. Muharrem SHETA si Ortak me 50 % të kuotave pjesëmarrëse dhe Ortak I vetëm me 100 % të kuotave pjesëmarrëse është z. Ram SHETA Ortak i vetëm.
Veprimtaria e shoqërisë "DARDANIA HAS" SHPK rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, nga statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

Selia Qendrore në të cilën shoqëria zhvillon aktivitetin e saj sipas Certifikates Rregjistrimi të QKR datë 15.03.2006 me NIPT **K36306932R** është me Adresë Kryesore Lagja Nr.1 Rruga Burimi, ndertese private Nr.10 Krumë Has.
Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj edhe në Filialin e Tiranës në ambiente e vetë me Adresë Lagja Nr.1 Rruga Burimi, ndertese private Nr.10 Krumë Has.

*Aktiviteti Kryesor i Njesisë Ekonomike

Shoqëria "DARDANIA HAS" SHPK ka si objekt veprimtarinë në: **"Import – Export me shumice dhe pakice të mallrave industrial, materialeve të ndërtimit dhe materialeve hidraulike etj.."**.

Kontributi në shoqëri përfaqësohet nga kapitali i ortakut të vetëm.

*Zbatimi i rregullave të mbajtjes së kontabilitetit

Kontabiliteti është organizuar dhe mbajtur në pajtim me kërkesat e Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

Ngjarjet dhe veprimet ekonomike janë rregjistruar në regjistrat kontabel në mënyrë kronologjike dhe sistematike në programin e administrimit financiar dhe kontabel "BILANC".

Rregjistrimi i veprimeve ekonomike bazohet në Evidencën Mbështetëse.

Veprimet janë ngurtësuar me 31 Dhjetor 2020.

*Politikat Kryesore Kontabel.

Ndërtimi i Pasqyrave Financiare të shoqërisë (Bilanci Kontabel) për vitin 2020 bazohet në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe veçanërisht në SKK Nr. 2, në Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", Neni 4, pasi shoqëria plotëson kushtet për zbatimin e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.

Shifrat e Pasqyrave Financiare të shoqërisë (Bilanci Kontabel) për vitin 2020 janë të krahasueshme me vitin paraardhës, pasi janë zbatuar të njëjtat politika kontabel.

Politikat kontabel të Shoqërisë "DARDANIA HAS" SHPK reflektojnë praktikat e këtij aktiviteti.

Mbajtja e Kontabilitetit bëhet nëpërmjet rregjistrimit të veprimeve dhe fakteve ekonomike në ditar dhe llogari në mënyrë të kompjuterizuar në programin e administrimit financiar dhe kontabel "BILANC".

Sistemi Kontabel i zbatuar për marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare bazohet mbi të drejtat e konstatuara.

Standarti Kontabel që përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme për tu zbatuar në hartimin e pasqyrave financiare mbështetet në kërkesat e Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Pasqyrat Financiare sigurojnë transparencën dhe të dhënat e nevojshme për vendimmarrje.

Pasqyrat Financiare janë pregatitur bazuar në kontabilitetin ushtritor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë ekonomike.

Paraqitja dhe klasifikimi i elementeve të pasqyrave financiare është bërë në kohëracë në të dy ushtrimet.

Aktiviteti Aftëgjatë Material (AAM) shoqëria nuk ka pasqyruar AAM për këtë vit ushtritor.

Inventaret paraqiten në formë materiale dhe furnizimesh për tu përdorur në procesin e kryerjes së shërbimeve.

Inventari vlerësohet me koston e blerjes.

Shpenzimet janë kontabilizuar në bazë të dokumentit bazë të shpenzimeve.

Të ardhurat nga shitja janë kontabilizuar në bazë të faturave tatimore të shitjes.

II – SHPJEGIME TË ZËRAVE TË PASQYRAVE FINANCIARE (BILANCI KONTABEL)

Pasqyrat Financiare të vitit 2020 (BILANCI KONTABEL) janë hartuar sipas formatit të përcaktuar në Standartin Kombëtar të Kontabilitetit Nr. 2.

Çelja e llogarive të vitit 2020 rakordon me mbylljen e llogarive të vitit 2019.

Grupet dhe postet për ushtrimin e mbyllur 2020 dhe ushtrimin paraardhës 2019 rezultojnë si më poshtë:

SHËNIME: SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE

Periudha 1 Janar – 31 Dhjetor 2020

Shoqëria "DARDANIA HAS" SH.P.K

AKTIVI

Totali i AKTIVIT në ushtrimin e mbyllur 2020 rezulton me Vlere Neto 38,868,016 leke.

Aktivet e shoqërisë përfaqësohen nga :

I - AKTIVE AFATSHKURTËRA me Vlere Neto 26,800,248 Leke.

Aktivet Afatshkurtëra përfaqësohen nga :

I.a - Mjetet Monetare me 603,299 leke.

Gjendja e Mjeteve Monetare në 31.12.2020 e krahasuar paraqitet :

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Para në Arkë	176,503	450,716	(274,213)
Para në Bankë	200,681	152,583	48,048
Totali	377,184	603,299	(226,115)

I.b - Aktive të tjera financiare afatshkurtëra me vlerë 10,860,818 leke përfaqësohen nga :

-Detyrimet e klientëve ndaj shoqërisë për shitje shterimesh për faturat e papaguara deri në datë 31.12.2020 në vlerën 9,377,130 leke, Tatim fitimi i mbipaguuar duke zbritur fitimin e vitit ushtrimor paraqitet 45,913 leke, Tvsh Kreditore 1,437,775leke, Detyrimet e Ortakut ndaj shoqërisë për shumën 0 leke.

Gjendja e Kërkesave të Arketueshme në 31.12.2020 e krahasuar paraqitet :

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>32 Dhjetor 2019</u>	<u>Ndryshimi + / -</u>
Klienter	9,377,130	6,208,531	3,168,599
Tvsh Kreditore	1,437,775	1,850,293	(412,518)
Tatimi mbi Fitimin	45,913	157,478	(444,565)
Tap	0	0	0
Detyrime Ortaku	0	0	0
Sigurime	0	0	0
TOTALI	8,216,302	8,216,302	2,644,516

I.c - Inventari Mallrave & Aseteve me vlerë kontabile i paraqitur 31.12.2020 paraqitet për 24,630,014 leke.

Gjendja e Inventarit në 31.12.2020 e krahasuar paraqitet :

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>32 Dhjetor 2019</u>	<u>Ndryshimi + / -</u>
Inventari	21,243,712	17,980,647	3,263,065
Inventari Asete	3,386,302	2,341,601	1,044,701
TOTALI	24,630,014	20,322,248	4,307,766

DETYRIMET dhe KAPITALI

Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit të shoqërisë në për vitin 2020 rezultojnë me Vlere Neto 35,868,016 leke.

I - DETYRIME AFATSHKURTERA me Vlere Neto 25,991,142 leke, që përfaqësohen nga :

I.a -Hua 6,000,000 leke *Furnitore* 16,605,953 leke, *Paga* per shumën 0 leke, *Sigurime* shoqërore dhe shëndetsore për shumën 87,140 leke, *Tap* per shumën 650 leke, *Detyrimin ndaj Ortakut* shumën 3,297,399 leke.

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>	<u>Ndryshimi +/-</u>
Hua	6,000,000	6,000,000	0
Furnitor	19,389,137	12,906,617	6,482,520
Paga	0	34,220	(34,200)
Sigurime	87,140	86,490	650
Tap	650	1,300	(660)
Ortaku	514,215	127,252	386,963
TOTALI	25,991,143	19,155,889	6,835,253

II - KAPITALI në Vlerë Neto 9,876,874 leke.

Kapitali i shoqërisë në vitin 2020 paraqitet me rritje në shumën 245,681 leke.

* Kapitali aksioner me vlerë 1,182,846 leke.

* Rezerva Ligjoze 28,000 leke

* Fitimi i mbartuar në vite 8,420,347 leke

* Fitimi i vitit financiar 245,681 leke

Përfaqëson rezultatin sipas PASH per vitin 2020.

III - INFORMACION SHPJEGUES PËR PASH-in.

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve është përgatitur sipas Formatit Nr. 1 të përcaktuar në SKK Nr. 2.

Të ardhurat nga shitja përfaqësohen kryesisht nga të ardhurat e shijeve të ndryshme.

Të ardhurat e vitit 2020 detajohen :

Emertimi	Shuma	Monedha
Të ardhura të Tatueshme	40,687,699	leke
Të ardhura nga interesat	2,265	leke
TOTALI	40,689,964	leke

Shpenzimet e paraqitura në PASH dhe kryesisht shpenzimet e blerjeve të materialeve të para , punime dhe blerje furniturash nga të tretë janë shpenzime të regjistruara sipas faturave tatimore bazuar në emimin e blerjes.

Shpenzimet për personelin përfaqësojnë fondin e pagave për vitin 2020.

Shpenzimet për të tjera përfaqësojnë Taksa vendore shpenzime bankare etj gjatë vitit 2020.

Shpenzimet financiare përfaqësojnë gjoha dhe demshperblime, humbje të ndryshme të shoqërisë, etj.

Shpenzimet kryesore për vitin 2020 detajohen :

Emertimi	Shuma	Monedha
Shpenzime për për materialet e konsumuara	32,171,885	leke
Fond Page	4,641,159	"
Amortizim	72,019	"
Shpenzime të tjera	3,515,865	"
TOTALI	40,400,928	leke

REZULTATI TË ARDHURA & SHPENZIME TATIMORE

	TË USHIRMIT	TATIMORE
TOTALI I TË ARDHURAVE NGA SHITJET	40,689,964	40,689,964
TOTALI I SHPENZIMEVE	40,400,928	40,400,928
FITIMI PARA TATIMIT	289,036	289,036
NORMA E TATIMIT MBI FITIMIN 15 %	43,355	43,355
FITIMI NETO	245,681	245,681

IV - INFORMACION SHPJEGUES PËR FLUKSIN MONETAR

Pasqyra e Fluksit Monetar të vitit 2020 është përgatitur sipas formatit të përcaktuar në SKK Nr. 2, Metoda Indirekte.

Sipas Pasqyrës së Fluksit të Parasë të vitit 2020 shoqëria paraqitet me ulje monetare prej 226,115 leke.

V - INFORMACION SHPJEGUES PËR PASQYREN E LËVIZJES KAPITALIT

Pasqyra e Lëvizjes së kapitalit është përgatitur sipas formatit të përcaktuar në SKK Nr. 2.

Sipas Pasqyrës së Lëvizjes së Kapitalit të vitit 2020 kapitali neto i shoqërisë rezulton me rritje në shumën 245,681 leke.

PËRFAQËSUESI I SHOQËRISË

Ram SHETA

SHËNIME: SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE

Periudha 1 Janar – 31 Dhjetor 2020

Shoqëria "DARDANIA HAS" SH.P.K